

AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE AKSIONERE
"ALBA COSMETIC INTERNATIONAL" sha

Me ane te ketij dokumenti, te hartuar ne 4 (kater) kopje origjinale, aksioneret,

Z. Adi Mehmeti, i biri i Gani-ut, i datelindjes 04/12/1993, banues ne Tirane te ish-fusha e Aviacionit, Rr.Riza Kolonja, shtepi private nr 46, identifikuar me karte identiteti me nr. personal J31204033Q.

Deklarojne se miratojne kete Akt Themelimi per Shoqerine "ALBA COSMETIC INTERNATIONAL" sha, e cila eshte themeluar me date 13/07/2020 me seli ne Durrës, me permbajtjen si vijon.

- 1). Te themeloje shoqerine aksionere me emrin "ALBA COSMETIC INTERNATIONAL" sha
- 2). "ALBA COSMETIC INTERNATIONAL" sha eshte person juridik shqiptar dhe si e tille do te filloje aktivitetin e saj pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Qendres Kombetare te Regjistrimit si dhe ne organet tatimore.
- 3) Aktivitetit i saj do te zhvillohet sipas ketij Akt-Themelimi, Statutit bashkalidhur dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 4) Kohezgjatja e aktivitetit fiksohet per nje periudhe kohe te pakufizuar.
- 5) Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj si me poshte.
 - Prodhim dhe ambalazhim i bombulave te gazit njeperdorimshe te gramaturave te ndryshme.
 - Tregtim me shumice e pakice, import-eksport i ambalazheve te ndryshme, produkte te ndryshme te estetikes, kozmetikes dhe parfumerise, shampo, aromatizues te llojeve te ndryshme, sprait per insekte, produkte te higjenes, produkte ushqimore te bukurise, trajtimit te lekures si edhe detergjente te llojeve te ndryshme.
 - Transport mallrash brenda dhe jashte vendit.
- 6) Per permbushjen e objektit te veprimtarise, shoqeria mund te marre pjese ne bashkepunim me shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte ose te perafert me te sajin dhe mund te kryeje direkt apo indirekt te gjitha operacionet e nevojshme per realizimin e objektit te saj.

Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo valuata te tjera, prane bankave shqiptare apo te huaja, duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluar ne to, konform legjislacionit ne fuqi.

7) Selia e shoqerise eshte ne adresen, *Lagja Porto Romano, Rr. Velipoja, Durrës*. Asambleja ka kompetencen te hape filiale e agjensi te tjera dhe t'i mbylle nese e quan te nevojshme.

8) Kapitali themeltar i shoqerise eshte 374.000.000 (treqind e shtatedhjete e kater milion) lek nga te cilat 178.098.377 (njqind e shtatedhjete e tete milion e nentedhjete e tete mije e treqind e shtatedhjete e shtate leke) jane ne para dhe 195.901.623 (njqind e nentedhjete e pese milion e nenteqin e njemije e gjateqind e njezete e tre) jane ne natyre.

Kapitali themeltar i shoqërisë eshte i ndare ne 100 (njqind) aksione me vlere nominative 3.740.000 (tre milion e shtateqind e dyzetmije) leke secila. Aksionet janë të pandashme.

Kapitali themeltar është nënshkruar dhe eshte shlyer plotësisht nga aksioneret themelues te cilet i zoterojne aksionet si me poshte.

Aksioneri Adi Mehmeti zoteron 100 aksione barabarte me 100% te kapitalit themeltar.

9) Administrator i shoqerise, i emeruar per nje periudhe kohe 3-vjecare me te drejte riemerimi eshte Z. Adi Mehmeti, i biri i Gani-ut, i diatelindjes 04/12/1993, banues ne Tirane te ish-fusha e Aviacionit; Rr.Riza Kolonja, shtepi private nr 46, identifikuar me karte identiteti me nr. personal J31204033Q.

Ai ka te drejten e firmes dhe te perfaqesimit te shoqerise.

Administratori gezon kompetenca te pakufizuara per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe jane ngarkuar asamblese se pergjithshme.

Ne permbushje te detyres se tij mund te vere ne levizje instanca juridike dhe administrative, duke emeruar avokate e duke leshuar prokura ne raste gjyqesh, te kryeje operacione bankare, perfshire ketu edhe hapjen e llogarive rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdher-xhirimi, tituj krediti, paradhenie krediti.

Administratori ne perfundim te cdo viti ekonomik perpilon nje relacion mbi aktivitetin e zhvilluar, objektivat e arritura dhe perspektiven e shoqerise, si dhe pergatit bilancin perfundimtar qe ia paraqet cdo vit Asamblese per aprovim.

Keshilli i Administrimit perbehet prej 3 (tre) anetaresh te zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme.

Perberja e Keshillit te pare Mbikqyres eshte si me poshte.

- 1- Muharrem Çela Anetar, lindur me 15/02/1972 me nr. Personal H20215015W,
- 2- Shkelqim Çerri Anetar, lindur me 05/05/1979 me nr personal H90505098W,
- 3- Idajet Çela Anetar, lindur me 20/03/1976 me nr. Personal H60320016Q,

Kohezgjatja e funksionit te anetareve te Keshillit te Administrimit eshte 3 (tre) vjet. Anetaret e Keshillit te Administrimit, kane te drejte te rizgjidhen. Ata mund te shkarkohen ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjithshme.

Kompetencat e funksionimit te tij rregullohen nga statuti bashkelidhur.

Kryetar i Keshillit te Administrimit emerohet Z. Muharrem Çela lindur me 15/02/1972 mbajtes i psaports me nr. personal H20215015W.

Ekspert kontabel i Shoqerise emerohet Z. Altin Sulejmani, i biri i Petritit, dt. 26/02/1981, banues ne Durres, Lagjia nr.7, mbajtes i kartes se identitetit me nr. personal I10226158U, dhe i pajisur me License Nr. 345 date 16/01/2015 . Kompetencat e Ekspertit Kontabel rregullohen ne baze te statutit.

10) Viti ekonomik fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

11) Ne nje liber te posacem te shoqerise shenohet kapitali themeltar, vlera e kontributit dhe aksionet e aksionerit te vetem.

Ne perfundim te vitit ekonomik, pas aprovimit te bilancit, Asambleja pasi ka ndare fondet per likuidimin e detyrimeve ndaj te treteve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos per ndarjen e fitimit neto. Per humbjet pergjigjet eskluzivisht shoqeria me kapitalin e saj.

12) Aksioneret mund ta zmadhojne kontributin e tyre dhe si pasoje edhe kouten e tij, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqerise, konforme asaj se parashikuar ne Statutin e shoqerise.

13) Aksioneret, Administratori dhe Anetaret e Keshillit te Administrimit jane te detyruar te ruajne sekretin mbi dokumentacionin dhe te dhenat, njohurite dhe

eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, dhe marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe pjeserisht.

Ata jane pergjegjes per pasojat negative qe mund te vijne nga shkelja e dispozites se mesiperme. Sa me siper vlen edhe per edhe per Ekspertin Kontabel te Miratuar.

Aksioneret jane pergjegjes, ndaj te treteve per demet qe mund t'u shkaktohen nga anullimi apo deklarimi i pavlefshem i ketij akti themelues.

Per sa nuk specifikohet shprehimisht ne kete akt, vlejne normat e Statutit bashkangjitur.

Paralelisht me nenshkrimin e ketij akti, aksioneri i vetem nenshkruan edhe Statutin e shoqerise "ALBA COSMETIC INTERNACIONALE" sha, i cili i bashkalidhet aktit te themelimit dhe eshte pjese perberese e tij.

AKSIONERI I VETEM I SHOQERISE

"ALBA COSMETIC INTERNACIONAL" sha

/ Adi Mehmeti

